



Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian

NJOFTIM PËR SHTYP

12 Nëntor 2015

Fillimi i Projektit të Binjakëzimit "Mbështetje për Zhvillimin e Zgjidhjeve Alternative të Mosmarrëveshjeve në Shqipëri"

Bashkimi Evropian, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit në Shqipëri organizuan sot një ceremoni zyrtare për fillimin e Projektit të Binjakëzimit "Mbështetje për Zhvillimin e Zgjidhjeve Alternative të Mosmarrëveshjeve" ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Institutit Kombëtar për Shëndetësi dhe Mirëqenie në Finlandë në partneritet me Institutin Çek të Shërbimit të Provës dhe Ndërmjetësimit.

Gjatë 18 muajve të zbatimit të tij, projekti ofron eksperiencën Çeke dhe Finlandeze në Shqipëri. Ekspertët do të bashkëpunojnë me përfaqësues të vendit përfitues në aktivitete të ndryshme kryesisht në fushën e Ndërmjetësimit. Tre komponentët kryesorë të Projektit të Binjakëzimit janë: Konsolidimi i kornizës ligjore, fuqizimi i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit që përfshin përveç të tjerave Trajnimin e Trajnerëve, Rritjen e Ndërgjegjësimit për ndërmjetësimin dhe bashkëpunimin ndër-institucional. Gjatë ceremonisë së hapjes Z. Yngve Engstrom, Shef i Bashkëpunimit në Delegacionin Evropian në fjalimin e mbajtur theksoi që "përdorimi i ndërmjetësimit dhe formave alternative të zgjidhjes së konflikteve promovon respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të tilla si përmirësimi i aksesit në drejtësi për të mitur dhe grupet vulnerabël. Gjithashtu mund të ofrojë një mbështetje të rëndësishme në mënyrë që institucionet kombëtare të adresojnë çështjet e prapambetura në gjykatë. Aksesi për një drejtësi eficiente dhe të paanshme është një aspekt shumë i

rëndësishëm për zgjerimin e BE-së, por më e rëndësishme është një e drejtë e qytetarëve Shqiptarë, dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në Shqipëri.

Z. Engstrom theksoi gjithashtu faktin që BE po ofron një asistencë prej më shumë se 86.5 million EURO në fushën e drejtësisë. Mbështetja fokusohet në reformat kryesore institucionale dhe rritjen e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm të gjyqësorit.

Z. Ildir Peçi në fjalimin e tij theksoi ngarkesën e gjyqtarëve dhe rëndësinë e Ndërmjetësimit në Shqipëri. Ai pohoi se ka besim se kjo reformë që deri në këtë moment ka munguar, jo vetëm që do modernizojë sistemin e drejtësisë, por është pa dyshim një hap i rëndësishëm drejt reformës në drejtësi pasi do të lehtësojë të gjithë procesin gjyqësor. "Ne sot po shënojmë një prej arritjeve të rëndësishme në fillimin e reformimit të sistemit tonë të përbashkët gjyqësor transparent dhe efikas në të cilin qytetarët me zgjedhjen e tyre të lirë dhe me më pak shpenzime do të marrin drejtësinë efektive. Znj. Bronislava Tomasova, Ambasadore e Republikës Çeke siguroi se ekspertët e Republikës Çeke do të ofrojnë ekspertizën e tyre më të mirë në fushë, pasi e konsiderojnë ndërmjetësimin si mënyrën më të mirë për të zgjidhur konfliktet. Z. Timo Sorsa, Drejtues i Projektit deklaroi se qëllimet kryesore të projektit synojnë të promovojnë vizibilitetin, njohurinë, besueshmërinë, aksesin dhe informacionin për shërbimin e ndërmjetësimit. Qëllime të tjera janë promovimi i efikasitetit dhe ndikimi i shërbimeve, për të promovuar praktikën e më të mirë, dhe për të përgatitur manuale udhëzimi për to. Z Sorsa theksoi se shkëmbimi i hapur dhe transparent i informacionit është i dobishëm për të gjithë ne dhe do të ndihmojë në arritjen e rezultateve të qëndrueshme nga projekti.

Znj. Drita Avdyli, Kryetare e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit në Shqipëri shpjegoi veprimtarinë e Dhomës dhe rëndësinë e procesit të ndërmjetësimit për të shmangur procesin gjyqësor. Në përfundim Z. Martin Kracik, bashkëdrejtues i projekti dhe Znj Marjo Naapi, Këshilltare e

Përhershme e Binjakëzimit dhanë një pasqyrë të shkurtër teknike të projektit, duke shpjeguar në detaje objektivat, komponentët dhe nën komponentët e projektit.